



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT I PJESSHËM MBI  
VEPRIMTARINË E  
GJYQËSORIT DHE DISA  
ORGANEVE TË QEVERISJES  
TË DREJTËSISË NË  
KUSHTET E PANDEMISË  
COVID-19

**15 MARS - 15 QERSHOR 2020**



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Korrik 2020

## **RAPORT I PJESSHËM MBI VEPRIMTARINË E GJYQËSORIT DHE DISA ORGANEVE TË QEVERISJES TË DREJTËSISË NË KUSHTET E PANDEMISË COVID-19**

**Për periudhën tre mujore 15 Mars – 15 Qershor 2020**

### **Përmbledhje Ekzekutive**

Pandemia globale Covid-19, ashtu si në vendet me një demokraci të konsoliduar, krijoi një sërë vonesash dhe vështirësish në sistemin e drejtësisë në vendin tonë, duke sjellë pengesa në të drejtën e aksesit të qytetarëve në organet e sistemit gjyqësor.

Gjatë kësaj periudhe, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në zbatim të projektit “Të drejtat e personave të privuar nga liria në gjendjen e fatkeqësisë natyrore”, të mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), ka monitoruar në mënyrë proaktive mediat, faqet zyrtare të institucioneve të sistemit të drejtësisë, si dhe ka grumbulluar informacion nëpërmjet korrespondencave zyrtare të shkëmbyera me këto institucione.

Në fokus të këtij raporti të pjesshëm monitorimi janë veprimtaria e disa institucioneve të sistemit të drejtësisë, përkatësisht e Prokurorit të Përgjithshëm, Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ-së), Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD-së).

Raporti reflekton të dhënat dhe gjetjet e evidentuara gjatë këtij procesi monitorimi, të cilat prekin gjithashtu edhe pezullimin e veprimtarisë e gjykatave gjatë kësaj periudhe, vështirësitë e hasura, si dhe ndalet veçanërisht tek aksesit në drejtësi të qytetarëve dhe vakumi ligjor për përdorimin e mjeteve audio-vizuale në seancat gjyqësore. Në përfundim, raporti adreson disa rekomandime për mbarëvajtjen e veprimtarisë së këtyre institucioneve, garantimin e plotë të parimit të “ligjshmërisë”, menaxhimit dhe koordinimit më të mirë të situatës nga institucionet, me qëllimin madhor garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut duke patur në fokus të veçantë elementët e procesit të rregullt dhe aksesin në drejtësi.

Raporti vlerësohet i pjesshëm pasi bazohet kryesisht në të dhënat e siguruar nga vetë institucionet e monitoruara, faqet e tyre zyrtare, etj. KShH vijon të monitorojë veprimtarinë e këtyre institucioneve dhe në periudhën në vijim pritet të publikojë raporte më të plota, në varësi të të dhënave dhe informacioneve që do të sigurohen nga këto monitorime.

Në përgjithësi, KShH vëren se veprimtaria e institucioneve të drejtësisë që janë monitoruar, nuk ka ndalur edhe gjatë periudhës së pandemisë. Gjithësesi kjo veprimtari shënon ritme relativisht të ngadalta. Sfida kryesore e këtyre institucioneve ka qenë përshtatja e veprimtarisë së tyre me metodat e reja të teknologjisë së informacionit që do të mundësonin



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

një vijueshmëri më të mirë të punës dhe përmbushjes së objektivave të tyre. Në këtë drejtim, edhe kuadri ynë ligjor procedural që rregullon veprimtarinë e gjykatave rezultojnë të ketë mangësi sa i takon dispozitave që do duhet të rregullonin vijueshmërinë e punës së gjykatave online, duke mundësuar këtu përdorimin e videokonferencës për zhvillimin e seancave gjyqësore, në kushtet e kësaj pandemie globale të paprecedentë jo vetëm për vendin tonë, por mbarë botën.

Gjatë muajve Mars – Prill 2020, Prokurori i Përgjithshëm rezultojnë të ketë nxjerrë disa udhëzime për masat procedurale dhe masat mbrojtëse ndaj prokurorëve me juridiksion të përgjithshëm dhe administratës së prokurorisë, e cila ka mundësuar edhe pse me kufizime, vijueshmërinë e punës në këto prokurori në kushtet e Covid 19. KShH ka rekomanduar që gjatë kësaj periudhë, prokuroria të kërkojë me inisiativën e saj ndryshimin e masave të sigurimit “arrest në burg” për një kategori shtetasish të paraburgosur në sistemin e burgjeve, të cilët nuk kanë rrezikshmëri të theksuar shoqërore dhe i përkasin grupeve në nevojë. Por përkundrajt këtij rekomandimi, nuk rezultojnë që në praktikën e prokurorëve të jetë reflektuar ndjekja e kësaj praktike ligjore.

Gjatë periudhës 18 Mars – 12 Qershor 2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) rezultojnë të ketë zhvilluar 9 mbledhje plenare, ose mesatarisht 3 mbledhje në muaj. Në fokus të veprimtarisë së këtij Këshilli ka qenë procesi i vlerësimit të veprimtarisë etiko-profesionale të magistratëve prokurorë, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të magistratëve, plotësimi i 3 (tre) vendeve vakante pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, caktimet e përkohshme në pozicionet e prokurorëve (nga një prokurori në tjetrën), procedurat që mundësojnë shqyrtimin e ankesave kundër arkivimit të hetimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), etj.

Duke filluar nga 12 Mars 2020, KLGJ ka zhvilluar online veprimtarinë e tij (mbledhjet plenare) nëpërmjet platformave elektronike, duke realizuar në harkun kohor tre muaj, 12 mbledhje plenare ose mesatarisht 4 mbledhje në muaj, të cilat kanë sjellë miratimin e 33 vendimeve të rëndësishme. Këto vendime i kanë ardhur në ndihmë, ndër të tjerash, menaxhimit të situatës në kushtet e Covid 19, ngritjes së strukturave me natyrë monitoruese dhe analizuese brenda KLGJ-së, vijueshmërinë e procesit të plotësimit të vakancave në pozicionet në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (të cilat kanë ecur me hapa relativisht të ngadaltë), etj. Me anë të tre vendimeve të njëpasnjëshme, për gati 6 javë, KLGJ ka vendosur të pezullojë veprimtarinë dhe shërbimet gjyqësore në të gjitha gjykatat në RSH (nga dt. 10.03.2020 deri në dt.22.04.2020), me përjashtim të çështjeve me natyrë të ngutshme, çështjeve të lidhura me masat e sigurimit, etj, **të vlerësuara si të tilla rast pas rasti nga vetë trupat gjyqësore.** KLGJ vendosi rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore më datë 27.04.2020.

Në tërësi vërehet se ndërmjet KLGJ-së dhe KLP-së ka patur një mënyrë të ndryshme të përballimit të situatës. KLGJ ka qenë relativisht më pro-aktive në menaxhimin e situatës për vijueshmërinë e veprimtarisë në gjykata. Më gjithë, në këtë drejtim ka ndikuar edhe fakti se prokuroritë janë të organizuara pranë gjykatave dhe veprimtaria e tyre është e ndërlidhur ngushtësisht dhe e ndërvarur nga veprimtaria e gjykatave.





## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Pavarësisht dobishmërisë së Aktit normativ me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave, nr. 9, dt. 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19” dhe ndryshimeve të mëpasshme të tij, KShH vëren se miratimi i aktit nuk u harmonizua reciprokisht në kohë me veprimtarinë e KLGJ-së për rifillimin e punës së pezulluar në gjykata si dhe me dispozitat e legjislacionit procedural (civil, penal dhe administrativ).

Teksa KLGJ vendosi të rifillojë veprimtarinë dhe shërbimet gjyqësore në gjykata në dt. 27 Prill 2020, akti normativ i sipërpërmendur i hapi rrugë rifillimit të punës në gjykata në dt. 27 Maj 2020, pra gati një muaj me vonë. Në aktin normativ të ndryshuar, parashikohet që seancat gjyqësore do të zhvillohen me dyer të mbyllura, ndërkohë që diskrecioni për këtë, sipas Kodit të Procedurës Civile dhe atij Penal është atribut eskkluziv që rast pas rasti i përket trupit gjykues, bazuar në rrethanat e parashikuara në dispozitat përkatëse të këtyre dy Kodeve. Vendimet e KLGJ-së dhe akti normativ me fuqinë e ligjit (i ndryshuar) nuk rezultojnë të jenë në pajtim të plotë me Kodin e Procedurës Civile dhe atë Penale. Përdorimi i sistemit audio-vizual për realizimin e proceseve gjyqësore respektive është i limituar për tu përdorur nga gjykata sipas këtyre Kodeve, vetëm në raste dhe rrethana specifike që nuk përgjithësojnë përdorimin e tyre në çdo rast, në kushtet e pandemisë.

Edhe pse kanë kaluar më shumë se tre muaj nga përballja e vendit tonë me këtë pandemi, mungojnë të dhënat zyrtare për çështjet me karakter urgjent që kanë vijuar të shqyrtohen gjatë kohës që veprimtaria gjyqësore është pezulluar dhe në çformë janë realizuar ato, në ç’masë është përdorur teknologjia e informacionit për realizimin e seancave gjyqësore dhe sa e kanë mundur kushtet infrastrukturore zhvillimin e këtyre seancave me anë të kësaj teknologjie.

Referuar materialeve dhe analizave të publikuara në media si dhe ankesave që KShH ka trajtuar në këtë periudhë, veçanërisht nga shtetasit e privuar nga liria, është vërejtur se aksesit në drejtësi i qytetarëve është bllokuar në një shkallë tepër të lartë, veçanërisht gjatë periudhës së parë të pandemisë (për gati dy muaj e gjysëm).<sup>1</sup>

### **1. Veprimtaria e institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme**

Në përputhje me nenet 148 e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 24 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, si dhe parashikimet në ligjin e posaçëm nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, prokurori luan një rol kyç në ushtrimin e ndjekjes penale si dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit.

Në muajin Prill 2020, në kuadër të trajtimit të ankesave të adresuara nga ana e shtetasve të dënuar dhe familjarëve të tyre lidhur me zbatimin e Aktit Normativ nr. 7, dt. 23.03.2020 “Për Qëndrimin e Përkohshëm në Shtëpi të të Dënuarve”, KShH ju drejtua institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme duke rekomanduar vlerësimin e alternativave të tjera të masave shtesë që parandalojnë përhapjen e COVID – 19 në sistemin e burgjeve dhe

<sup>1</sup> <https://www.reporter.al/pezullimi-i-gjyqeve-nga-covid-19-vonoi-drejtisine-per-qytetaret/>  
<https://faktoje.al/mbyllja-e-gjykatave-si-pasoje-e-covid-19-shton-rrezikun-per-drejtisi-te-munguar/>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

garantojnë mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor. Konkretisht përsa i përket kompetencave të organit procedues, KShH rekomandoi bashkërendimin e nismave me pushtetin gjyqësor për të zbatuar nenin 260 të Kodit të Procedurës Penale që parashikon revokimin, zëvendësimin dhe bashkimin e masave të sigurimit. KShH i rekomandoi përfaqësuesve të organit të akuzës që të kërkonin me inisiativën e tyre zëvendësimin dhe revokimin e masave të sigurimit, nga arrest në burg në një masë sigurimi më të lehtë, me fokus të veçantë kategoritë në nevojë që ndodhen në sistemin e burgjeve, të cilët nuk shfaqnin rrezikshmëri të lartë shoqërore. Në praktikë, referuar zhvillimeve të pasqyruara në media por edhe korrespondencës zyrtare që kemi patur me Prokurorinë e Përgjithshme nuk rezultoi që me inisiativë prokurorët të kenë kërkuar ndryshimin/zëvendësimin e masave të sigurimit. Në fakt kanë qenë avokatët e personave të paraburgosur që kanë vendosur në lëvizje gjykatën për ndryshimin e masave të sigurimit. Si nga pikëpamja ligjore por edhe nga praktika e organit të prokurorisë, për lehtësimin e sistemit penitenciar nga personat e paraburgosur nuk ka patur asnjë zhvillim pozitiv në kushtet kur siguria dhe jeta e tyre potencialisht u vendos në rrezik për shkak të pandemisë globale.

KShH në bashkëpunim me tre organizata të tjera jofitimprurëse<sup>2</sup> ju drejtua Prokurorit të Përgjithshëm dhe institucioneve të drejtësisë në vendin tonë, duke kërkuar informacion mbi hapat e ndërmarra për vijueshmërinë e punës për zbatimin e reformës në drejtësi dhe rifillimin në mënyrë të plotë të veprimtarisë gjyqësore në vendin tonë, në kushtet e pandemisë globale Covid-19. Nëpërmjet shkresave nr. 301/1 prot., dt. 23.04.2020 dhe nr. 355/1 Prot.A.C., dt. 28.05.2020, Prokurori i Përgjithshëm na informoi mbi miratimin e tre udhëzimeve të përgjithshme. Konkretisht:

- **Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 03, dt. 19.03.2020 “Disa masa procedurale në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes Covid-19”.** Qëllimi i këtij udhëzimi synonte krijimin e sinergjive në marrjen e masave parandaluese, me qëllim shmangien e përhapjes së Covid-19 në sistemin e burgjeve. KShH vëren si një zhvillim pozitiv nenin 3 të këtij udhëzimi ku evidentohet domosdoshmëria e marrjes së masave procedurale në fazat e procedimit penal, nga ana e drejtuesve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, në këto tri drejtime:
  - i. **Në fazën e hetimeve paraprake,** vlerësimi i kërkesave për caktimin e masave të sigurimit personal duhet të synojë garantimin e sigurisë së nevojshme të personit të ndaluar, arrestuar ose personit nën hetim.
  - ii. **Në fazën e diskutimeve përfundimtare në gjykimet e themelit,** të vlerësohen kushtet dhe kriteret për të kërkuar caktimin e dënimeve alternative të dënimit me burgim.
  - iii. **Në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë,** të vlerësohet përmbushja e kushteve dhe kriterëve ligjore për të kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim ose vuajtja e dënimit të mbetur me qëndrim në shtëpi.

<sup>2</sup> Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Instituti për Studime Politike dhe Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- **Udhëzim i Përgjithshëm nr. 04, dt. 24.03.2020** “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga Covid-19”. Udhëzimi i adresohet në mënyrë të drejtpërdrejtë punonjësve në administratën e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe shtetasve të interesuar për shërbime në prokurori. Nëpërmjet këtij udhëzimi përcaktohet domosdoshmëria për ndërmarrjen e masave administrative për: *kufizimin e kryerjes së veprimeve hetimore që kanë të bëjnë me marrjen e deklarimeve nga personat që kani dijeni mbi veprën penale, të pandehurit apo personat nën hetim; kufizimin e orareve të takimit me qytetarët; kufizimin e veprimeve procedurale në ambientet e spitaleve, ambulancave apo laboratorëve mjekësorë; kufizimin e veprimtarisë administrative të zyrave të sekretarisë; etj.*
- **Udhëzim i Përgjithshëm nr. 06, dt. 27.04.2020** “Për masat procedurale dhe administrative në veprimtarinë funksionale dhe mbarëvajtjen e punës në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të kufizimit të përhapjes së Covid-19”. Në nenin 3 të këtij udhëzimi reflektohet natyra vijuese e tij, pra ky është një udhëzim që vjen si pasojë e rënies së kufizimeve të normuara në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 5, dt. 07.04.2020. **KShH konstaton se ky i fundit nuk është publikuar në faqen zyrtare të institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme<sup>3</sup>, ndërkohë që as në korrespondencën e shkëmbyer me këtë institucion nuk rezulton të jetë cituar apo bashkëlidhur.**

Në përputhje me nenin 3 konstatohet se më dt. 27.04.2020, rifillimi i veprimtarisë gjyqësore në vendin tonë ka sjellë dhe rifillimin e veprimtarisë së ushtrimit të kompetencave dhe funksioneve nga ana e prokurorëve.

Nenet 4, 5 dhe 6 të këtij udhëzimi reflektojnë masat higjeno-sanitare që duhet të ndërmerren nga ana e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore (OPGJ) dhe punonjësve të administratës. Në nenin 3 të Udhëzimit është vlerësuar nevoja e marrjes së masave procedurale për të gjitha fazat e procedimit penal, në përputhje me masat kufizuese të reflektuara në Aktin Normativ nr. 9, dt. 25.03.2020.

- Gjatë fazës së hetimeve paraprake**, është udhëzuar prioritizimi i çështjeve nga ana e OPGJ-ve, me qëllim realizimin e veprimeve hetimore me planifikim;
- Gjatë fazës së gjykimit**, është udhëzuar koordinimi dhe bashkërendimi me përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor me qëllim sigurimin e prezencës së përfaqësuesve të organit të akuzës në gjyq;

Në përmbajtjen e këtyre udhëzimeve, KShH konstaton mundësinë e delegimit të së drejtës drejtuesve të prokurorive për të nxjerrë udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtyre udhëzimeve të përgjithshme. Kjo kompetencë gjen mbështetje në nenin 46, pika 4 të ligjit nr. 97/2016. Por nga pikëpamja e vizibilitetit dhe transparencës ndaj publikut, këto udhëzime nuk mund të aksesohen me mjetet e teknologjisë së informacionit që janë publike. KShH vëren se Prokuroritë pranë

<sup>3</sup> [http://www.pp.gov.al/web/Urdhera\\_Udhezime\\_te\\_Prokurorit\\_te\\_Pergjit\\_51\\_1.php#.XuoaSkUzbc](http://www.pp.gov.al/web/Urdhera_Udhezime_te_Prokurorit_te_Pergjit_51_1.php#.XuoaSkUzbc)



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Gjykatave të Shkallës së Parë dhe ato pranë Gjykatave të Apeleve në vendin tonë nuk disponojnë faqe zyrtare institucionale apo në rrjete sociale. Si rrjedhojë, miratimi i udhëzimeve të tilla të përgjithshme nga drejtuesit e këtyre prokurorive mund të publikohet në këndin fizik të njoftimeve në institucion, por është i paaksesueshëm për qytetarët të cilët nuk kanë kontakt fizik me nënpunësit e këtyre institucioneve.

### 2. Veprimtaria e institucionit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Në përputhje me nenin 149 e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe 101 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka kompetenca të rëndësishme në funksion të garantimit të pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, një ndër përgjegjësitë kyçe që ky institucion ushtron është informimi i publikut dhe Kuvendit mbi gjendjen e prokurorisë.<sup>4</sup>

Nëpërmjet korrespondencës zyrtare me këtë institucion (shkresës nr. 627/1 prot., dt. 09.06.2020 të dërguar nga KLP), jemi informuar se vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe VKM me karakter normativ i shtrijnë efektet edhe mbi sistemin e prokurorisë. KLP referon të ketë marrë të gjitha masat dhe ka mundur vazhdimin pa ndërprerje të veprimtarisë së tij. Konkretisht, KLP referon se:

- Ka vijuar procesin e vlerësimit të veprimtarisë etiko-profesionale të magjistratëve prokurorë, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve;
- Ka përfunduar procedurën e plotësimit të 3 (tre) vendeve vakante pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, si dhe ka vijuar procedurën për zgjedhjen e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit. **Nga shqyrtimi i seancave plenare të realizuara nuk rezultojnë që procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit të ketë vijuar.**
- Mbledhjet janë realizuar me ndihmën e platformave elektronike, ndërkohë që personeli administrativ ka vazhduar punën nga shtëpia.

Në faqen zyrtare të institucionit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezultojnë të publikuara njoftime lidhur me mbledhjet plenare të realizuara. Konkretisht mbledhja e parë plenare e realizuar me vendime qarkulluese mban datën 18 Mars 2020.<sup>5</sup> Në këtë mbledhje rezultojnë të jenë miratuar 5 vendimmarrje, të cilat kanë si synim caktimin e përkohshëm të prokurorëve<sup>6</sup> si dhe miratimin e listës me emrat e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.<sup>7</sup>

<sup>4</sup> Neni 149/a, pika 1, gërma dh) i Kushtetutës.

<sup>5</sup> <https://klp.al/2020/03/17/njoftim-seanca-plenare-nr-50/>

<sup>6</sup> [https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/img20200317\\_14212731.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/img20200317_14212731.pdf)

[https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/img20200317\\_14273665.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/img20200317_14273665.pdf)

[https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/img20200317\\_14300713.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/img20200317_14300713.pdf)

[https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/img20200317\\_14314016.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/img20200317_14314016.pdf)

<sup>7</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendimi-nr.84.pdf>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Për një periudhë 3 mujore, duke vendosur si referencë fillestare mbledhjen e dt.18 Mars 2020 (periudhën që shënon me fillimin e përhapjes së pandemisë globale në vendin tonë) deri në dt.12 Qershor 2020, KLP rezultoi të ketë zhvilluar me anë të platformave online, 9 mbledhje (seanca plenare), ose mesatarisht 3 mbledhje në muaj. Vendimmarrja e anëtarëve të KLP-së është realizuar nëpërmjet vendimeve qarkulluese me e-mail, ndërkohë që nënshkrimi i tyre është realizuar nga ana e anëtarëve të KLP-së në zyrë.

Përsa i përket mbledhjeve/seancave konkrete dhe vendimmarrjeve përkatëse, rezultoi se:

- **Data 25.03.2020** – Në këtë mbledhje janë marrë 6 vendime për caktim të përkohshëm të prokurorëve nga një prokurori në prokurorinë tjetër<sup>8</sup> dhe 1 vendim për mbarimin e mandatit të anëtarit të KLP-së Z. Dollapaj (për shkak të vendimit nr.4, dt. 12.03.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shkarkimin e tij nga detyra si prokuror).<sup>9</sup> Nga pikëpamja formale por edhe e transparencës ndaj publikut, vendimet për caktimin e përkohshëm të 6 prokurorëve në prokurori të tjera (përfshi këtu edhe vendimet e ngjashme të marra në mbledhjet vijuese), nuk shoqërohen me arsyetimin se në ç'kushte apo rrethana bëhet ky caktim i përkohshëm apo relacion shoqërues që do të mundësonte shpjegimin e pjesës arsyetuese të vendimeve.
- **Në mbledhjen plenare të datës 10.04.2020** u miratuan 3 vendime. Konkretisht për shpalljen e një vendi vakant për prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar;<sup>10</sup> për kontributin financiar të anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shpallur në vend,<sup>11</sup> si dhe për miratimin e heqjes dorë nga kandidimi për prokuror në Prokurorinë e Posaçme të Znj. Anita Jella.<sup>12</sup> Zhvillim pozitiv në këtë drejtim përbën vendimi nr. nr. 93, dt. 10.04.2020 i KLP-së në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas të cilit, anëtarët e KLP-së kanë dhuruar për muajin prill 50% të pagës neto mujore.
- **Data 15.04.2020** – Në këtë mbledhje, KLP ka shqyrtuar 3 çështje të ngritura, konkretisht caktimin e përkohshëm;<sup>13</sup> për krijimin dhe administrimin pranë KLP-së të dosjes personale dhe regjistrin të prokurorëve;<sup>14</sup> si dhe për dhënie leje të papaguar.<sup>15</sup>
- **Në mbledhjen e datës 24.04.2020**, anëtarët e KLP-së kanë miratuar 8 vendime për caktimin e përkohshëm,<sup>16</sup> 1 vendimmarrje për miratimin e Raportit të Veprimtarisë së

<sup>8</sup> [https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr\\_.85.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr_.85.pdf)  
[https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr\\_.86\\_compressed.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr_.86_compressed.pdf)  
[https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr\\_.87.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr_.87.pdf)  
[https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr\\_.88.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr_.88.pdf)  
[https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr\\_.89\\_compressed.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr_.89_compressed.pdf)  
[https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr\\_.91.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim.nr_.91.pdf)

<sup>9</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/03/vendim-nr.90.pdf>

<sup>10</sup> [https://klp.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim.nr\\_.92\\_10.04.2020.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim.nr_.92_10.04.2020.pdf)

<sup>11</sup> [https://klp.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim.nr\\_.93\\_10.04.2020.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim.nr_.93_10.04.2020.pdf)

<sup>12</sup> [https://klp.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim.nr\\_.94\\_10.04.2020.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim.nr_.94_10.04.2020.pdf)

<sup>13</sup> [https://klp.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim.nr\\_.95\\_15.04.2020.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim.nr_.95_15.04.2020.pdf)

<sup>14</sup> [https://klp.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim.nr\\_.96\\_15.04.2020\\_compressed.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim.nr_.96_15.04.2020_compressed.pdf)

<sup>15</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-1.pdf>

<sup>16</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-3.pdf>





## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KLP-së për periudhën Janar – Dhjetor 2019,<sup>17</sup> 4 vendimmarrje për miratimin e raporteve për analizimin e aftësive profesionale të 4 prokurorëve përkatës (në kuadër të procesit të vettingut), si dhe 1 vendim për transferimin e përhershëm të kancelarit të në Prokurorinë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.<sup>18</sup>

- **Mbledhja e datës 30.04.2020** e cila nuk rezulton të jetë reflektuar në seksionin e njoftimeve, në faqen zyrtare të KLP-së, ka prodhuar 1 vendimmarrje përsa i përket dhënien e lejes së papaguar për një afat 3 mujor për arsye familjare Prokurores pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.<sup>19</sup>
- **Më datë 15.05.2020**, në kuadër të ushtrimit të kompetencave funksionale në funksion të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, për shqyrtimin e projekt-raporteve të vlerësimit të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, KLP ka miratuar 9 raporte.<sup>20</sup> Gjithashtu në këtë mbledhje plenare u vendos bashkimi i procedurave administrative të filluara mbi bazën e vendimeve të mëparshme dhe vlerësimi përfundimtar e renditja e 4 kandidatëve të kualifikuar për plotësimin e 3 vendeve vakante për prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.<sup>21</sup> KLP vendosi miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për një subjekt prokuror<sup>22</sup> dhe miratoi komentet e kundërshtimet ndaj raportit të Shkollës së Magjistraturës me rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar në vitin akademik 2020-2021.<sup>23</sup>
- **Në rendin e ditës të mbledhjeve plenare të KLP-së të parashikuara në datat 18 dhe 19 Maj 2020 ka qenë procesi i vlerësimit të kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme.** Më konkretisht nëpërmjet platformave online, më dt. 18.05.2020 janë realizuar intervistat me 4 kandidatët.<sup>24</sup> Ndërkohë ditën e nesërme, më

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-5.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-7.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-8.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-11.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-12.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-13.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-14.pdf>

<sup>17</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-2.pdf>

<sup>18</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-15-16-compressed.pdf>

<sup>19</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-17-18.pdf>

<sup>20</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-114-15.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-115-15.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-116-15.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-117-15.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-118-15.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-119-15.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-120-15.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-121-15.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-122-15.05.2020.pdf>

<sup>21</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-113-15.05.2020.pdf>

<sup>22</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-123-15.05.2020.pdf>

<sup>23</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-124-15.05.2020.pdf>

<sup>24</sup> <https://klp.al/2020/05/18/keshilli-i-larte-i-prokurorise-zhvillon-intervistat-me-kandidatet-per-prokurorine-e-posacme/>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

dt. 19.05.2020, KLP ka miratuar listën e renditjes së kandidatëve për Prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme.<sup>25</sup> Në përputhje me këtë listë është realizuar emërimi i 3 kandidatëve si prokuror pranë kësaj Prokurorie.<sup>26</sup> Gjithashtu në këtë mbledhje është miratuar pjesëmarrja e prokurorëve në trajnimet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për periudhën Prill – Qershor 2020.<sup>27</sup>

- Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi dhe Rregullores së miratuar në vitin 2019 “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, në mbledhjen e datës 21.05.2020, KLP vendosi caktimin në pozicion të përkohshëm të 4 prokurorëve<sup>28</sup>, si dhe miratoi dhënien e lejes së papaguar për arsye familjare një prokuroreje pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.<sup>29</sup>
- **Mbledhja e fundit e këtij institucioni rezulton të jetë mbajtur më datë 12.06.2020.** Konstatojmë se vendimmarrjet e kësaj mbledhjeje (gjatë periudhës që mbulon ky monitorim) ende nuk janë zbardhur dhe nuk janë publikuar të arsyetuara në seksionin përkatës të faqes zyrtare.<sup>30</sup> Pas njohjes me njoftimin përkatës, rezulton se në këtë mbledhje janë miratuar 2 projekt-raporte në kuadër të rivlerësimit kalimtar për 2 subjekte prokurorë dhe ju janë përcjellë organeve përgjegjëse të vettingut. Për 3 subjekte prokurorë, Këshilli miratoi veprimtarinë jashtë funksionit të tyre, si: pedagog i jashtëm apo ekspert në kuadër të projekteve të zbatuara nga organizata ndërkombëtare. KLP ka realizuar hedhjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankesave kundër arkivimit të hetimit nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe ka vendosur fillimin e procedurave për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve si Inspektorë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. 6 (gjashtë) magjistratë prokurorë të cilët kanë shprehur interesin tashmë janë subjekte të procedurës administrative, pasi ndaj tyre Këshilli ka inicuar procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës. Procedura e verifikimit të pasurisë, figurës dhe plotësimi i kushteve dhe kriterëve ligjore ka filluar dhe për kancelarët në detyrë pranë 4 prokurorive, përkatësisht Prokurorive të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Korçë. Gjithashtu, KLP ka vendosur mbarimin e mandatit të statusit për shkak të dorëheqjes të një subjekti prokuror pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

KShH vlerëson pozitivisht nivelin e transparencës, sa i takon publikimit të mbledhjeve plenare të KLP-së dhe materialeve përkatëse në faqen e internetit, por vëren se mbledhjet e

<sup>25</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-125-19.05.2020.pdf>

<sup>26</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-126-19.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-127-19.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-128-19.05.2020.pdf>

<sup>27</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-129-19.05.2020.pdf>

<sup>28</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-130-21.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-131-21.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-132-21.05.2020.pdf>

<https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-133-21.05.2020.pdf>

<sup>29</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-134-21.05.2020.pdf>

<sup>30</sup> <https://klp.al/2020/06/12/vendimet-e-marra-ne-seancen-plenare-12-06-2020/>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

komisioneve të përhershme të KLP-së nuk reflektojnë transparencën e duhur pasi mungojnë (procesverbalet, projektvendimet, relacionet, etj).

### 3. Veprimtaria e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Për shkak të kufizimeve të vendosura në respektim të parandalimit të përhapjes së mëtejshme të Covid-19, qytetarët e kanë pasur të pamundur aksesimin në shërbime gjyqësore apo në seanca gjyqësore. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), nëpërmjet vendimmarrjeve të tij menaxhoi në mënyrë aktive situatën e shkaktuar, me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve.

Duke filluar nga 12 Mars 2020, ashtu sikurse KLP dhe KLGJ ka zhvilluar online veprimtarinë e tij (mbledhjet plenare) nëpërmjet platformave elektronike. Gjatë kësaj periudhe tre mujore, KLGJ rezultoi të ketë realizuar 12 mbledhje plenare ose mesatarisht 4 mbledhje në muaj, të cilat kanë sjellë miratimin e 33 vendimeve të rëndësishme që i kanë ardhur në ndihmë, ndër të tjerash, menaxhimit të situatës në kushtet e Covid 19.<sup>31</sup>

Në tërësi vërehet se ndërmjet KLGJ-së dhe KLP-së ka patur një mënyrë të ndryshme të përballimit të situatës. Siç kreu i KLP-së është shprehur në daljen e fundit mediatike, edhe ekspertët e KShH-së vërejnë se KLP ka qëndruar në pozita pritjeje<sup>32</sup>, ndërkohë që KLGJ ka qenë më pro-aktive në menaxhimin e situatës për vijueshmërinë e veprimtarisë në gjykata. Mgjth, në këtë drejtim ka ndikuar edhe fakti se prokuroritë janë të organizuara pranë gjykatave dhe veprimtaria e tyre është e ndërlidhur ngushtësisht dhe e ndërvarur nga veprimtaria e gjykatave.

Nëpërmjet shkresës nr. 2176/1 prot., dt. 26.05.2020, KLGJ na informoi mbi hapat e ndërmarrja për vijueshmërinë e punës për zbatimin e reformës në drejtësi dhe rifillimin në mënyrë të plotë të veprimtarisë gjyqësore në vendin tonë. Më konkretisht, bazuar në informacionin zyrtar të përcjellë nëpërmjet kësaj korrespondence dhe monitorimit online të faqes zyrtare të këtij institucioni rezultoi se:

- Nëpërmjet **vendimit nr. 127, dt. 10.03.2020** “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, KLGJ vendosi pezullimin e veprimtarisë për një periudhë 2 (dy javore). Për shkak të efekteve të këtij pezullimi janë përjashtuar **veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore, që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme, të vlerësuara si të tilla rast pas rasti nga gjyqtari; seancat e vlerësimit të masave të sigurisë, seancat në të cilat janë kërkuar ose zbatuar masat e sigurisë me burg, dhe kur të arrestuarit, të pandehurit, ose mbrojtësit e tyre e kërkojnë shprehimisht që të vijohet me shqyrtimin e tyre.**<sup>33</sup>

<sup>31</sup> Ky informacion i përkjet datës 26.05.2020.

<sup>32</sup> <https://klp.al/2020/04/22/ndikimi-i-pandemise-covid-19-ne-mbarevajtjen-e-punes-se-keshillit-te-larte-te-prokuroris/>

<sup>33</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.127-date-10.03.2020-per-pezullim-veprimtarie-ne-gjykata.pdf>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- Situata e krijuar nga Covid-19, diktoi KLGJ-në të zgjaste kohëzgjatjen e pezullimit dy herë me të njëjtën periudhë dy javore. Nëpërmjet **vendimit nr. 128, dt. 24.03.2020** “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, me të njëjtat efekte përjashtimore të sipërcituara, u vendos kohëzgjatja e pezullimit nga data 25.03.2020 deri më datë 07.04.2020.<sup>34</sup> Ndërkohë nëpërmjet **vendimit nr. 133, dt. 06.04.2020** “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, u përcaktua pezullimi i veprimtarisë për periudhën 08.04.2020 deri më 22.04.2020.<sup>35</sup>
- Më 16 Prill 2020, nëpërmjet **vendimit nr. 135**, KLGJ vendosi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19.<sup>36</sup> Ky Komision i Përkohshëm i cili e ushtron veprimtarinë deri në përfundim të gjendjes së epidemisë, ka si funksion dhe kryerjen e analizës së kuadrit ligjor në fuqi dhe bashkëpunimin me këshillat e gjykatave, kryetarët dhe kancelarët e tyre, për të evidentuar të gjitha problematikat që shfaq infrastruktura e gjykatave. Në vlerësimin e KShH-së, në fokus të veprimtarisë së këtij Këshilli duhet të kishte qenë edhe monitorimi i funksionimit të veprimtarisë dhe shërbimit gjyqësor në të gjitha gjykatat e vendit, duke publikuar në mënyrë periodike informacione lidhur me numrin e çështjeve, objektin e tyre dhe mënyrën se si u menaxhua vijueshmëria e tyre nga trupat gjyqësore të këtyre gjykatave. Edhe pse kanë kaluar më shumë se tre muaj nga përballja e vendit tonë me këtë pandemi, mungojnë të dhënat zyrtare për çështjet me karakter urgjent që kanë vijuar të shqyrtohen gjatë kohës që veprimtaria gjyqësore është pezulluar, nëse ka patur çështje të iniciuara (depozituara) nga palët, si është administruar shërbimi gjyqësor, etj. Perceptimi i publikut është se aksesimi në drejtësi, si pjesë substanciale e procesit të rregullt gjyqësor, rezulton të jetë bllokuar në një shkallë tepër të lartë, për shkak të pandemisë globale Covid – 19.<sup>37</sup>

Me iniciativën e këtij Komisioni, rezultojnë të jenë propozuar 4 projekt-vendime, të cilat më pas janë miratuar në mbledhjet plenare të KLGJ-së. Përkatësisht:

- Vendimi nr. 141, dt. 22.04.2020,**<sup>38</sup> nëpërmjet të cilit është miratuar Rregullorja për marrjen e masave kufizuese për përhapjen e Covid-19 gjatë

<sup>34</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.128.-date-24.03.2020-P%C3%8BR-VIJIMIN-E-PEZULLIMIT-TE-VEPRIMTARISE-SE-SHERBIMEVE-GJYQESORE-NE-TE-GJITHA-GJYKATAT-E-REPUBLIKES-SE-SHQIPERISE.pdf>

<sup>35</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/VENDIM-Nr.133-date-6.04.2020-vendim-Per-pezuillim-veprimtarie-ne-gjykata-.pdf>

<sup>36</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.-135-dat%C3%AB-16.04.2020-P%C3%8BR-NGRITJEN-E-KOMISIONIT-T%C3%8B-P%C3%8BR-KOHSHE-NE-TE-GJITHA-GJYKATAT-E-REPUBLIKES-SE-SHQIPERISE.pdf>

<sup>37</sup> <https://www.reporter.al/pezullimi-i-gjyqeve-nga-covid-19-vonoi-drejtisine-per-qytetaret/>  
<https://faktoje.al/mbyllja-e-gjykatave-si-pasoje-e-covid-19-shton-rrezikun-per-drejtisi-te-munguar/>

<sup>38</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/VENDIM-Nr.-141-dat%C3%AB22.04.2020P%C3%8BR-MIRATIMIN-ERREGULLORES-P%C3%8BR-MARRJEN-E-MASAVEKUFIZUESE-P%C3%8BR-P%C3%8BR-HAPIJEN-E-COVID-19-.pdf>





## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ushtrimit të veprimtarisë së KLGJ-së. Nëpërmjet dispozitave respektive që konsistojnë në përcaktimin e masave të përgjithshme të higjienës, detyrimet e strukturës përgjegjëse dhe detyrimet e punonjësit të KLGJ-së, kjo rregullore synon reduktimin e transmetimit të infeksionit midis punonjësve; sigurimin e një ambienti të shëndetshëm në punë dhe vijimësinë normale të aktivitetit të Këshillit.<sup>39</sup>

- ii. Nëpërmjet **vendimit nr. 142, dt. 22.04.2020** “Për rifillimin e veprimtarisë së KLGJ-së në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së Covid-19” u vendos rifillimi i veprimtarisë së KLGJ, i cili passjell dhe rifillimin e procedurave administrative të pezulluara, zgjatjen e afateve të kandidimit, si dhe rifillimin e procedurës administrative të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020.<sup>40</sup> **Referuar dokumentimit të mbledhjeve plenare nga data 30 Mars 2020, rezulton se KLGJ ka realizuar mbledhjet nëpërmjet video-konferencës, nën asistencën e specialistëve të misionit EURALIUS.**<sup>41</sup>
- iii. Me anë të **vendimit nr. 143, dt. 22.04.2020**, KLGJ vendosi rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore më datë 27.04.2020.<sup>42</sup> P.sh: nga monitorimi online i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë konstatojmë se nëpërmjet vendimit nr. 507/9 Prot., dt. 24.04.2020, Këshilli i Gjykatës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka miratuar Rregulloren “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.<sup>43</sup> Krahasimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila është e aksesueshme në webpage [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) ka publikuar për qytetarët vendimin 127, dt. 10.03.2020 të KLGJ-së, i cili është vendimi i parë që ka përcaktuar harkun e përkohshëm të pezullimit dhe që është pasuar me të tjera vendimmarrje. **Në funksion të garantimit të transparencës për publikun dhe mirëmenaxhimin e situatës së shkaktuar nga Covid-19 pa cënuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sugjerojmë unifikimin e praktikës ndërmjet gjykatave në vendin tonë dhe marrjen e masave konkrete dhe efektive për publikimin e Rregulloreve ndërinstitucionale të miratuara për kufizimin e përhapjes së Covid-19.**

<sup>39</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/RREGULLORE-%E2%80%99CP%C3%8BR-P%C3%8BRCAKTIMIN-E-MASAVE-P%C3%8BR-KUFIZIMIN-E-P%C3%8BRHAPJES-E-COVID-19-GJAT%C3%8B-USHTRIMIT-T%C3%8B-VEPRIMTARIS%C3%8B-S%C3%8B-K%C3%8BSHILLIT-T%C3%8B-LAR.pdf>

<sup>40</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/VENDIM-Nr.-142-dat%C3%AB-22.04.2020-P%C3%8BR-RIFILLIMIN-E-VEPRIMTARIS%C3%8B-S%C3%8BK%C3%8BSHILLIT-T%C3%8B-LART%C3%8BGJYQ%C3%8BSOR.pdf>

<sup>41</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/MBLEDHJE-E-KLGJ-s%C3%AB-Dat%C3%AB-30.03.2020-2.pdf>

<sup>42</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/VENDIM-Nr.-143-dat%C3%AB-22.04.2020-P%C3%8BR-RIFILLIMIN-E-VEPRIMTARIS%C3%8B-DHE-SH%C3%8BRBIMEVE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

<sup>43</sup> [http://www.gjykatatirana.gov.al/previewdoc.php?file\\_id=790](http://www.gjykatatirana.gov.al/previewdoc.php?file_id=790)



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- iv. **Vendimi nr. 146, dt. 27.04.2020**, solli përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në Gjykata. Këto masa të cilat referohen si detyrë që duhet të ndërmerret nga ana e Këshillave të Gjykatës, Kryetarit dhe Kancelarit synojnë krijimin e sinergjive dhe bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse si Prokuroria, Dhoma e Avokatisë, Drejtoritë/Komisariatet e Policisë, Institutin e Mjekësisë Ligjore etj., për të mundësuar komunikimin në distancë me gjykatën nëpërmjet postës elektronike dhe/ose telefonit/faksit.

KLJGJ ka shqyrtuar projekt-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet të cilit propozohen ndryshime në Aktin Normativ nr. 9, dt. 25.03.2020, dhe ka adresuar një set rekomandimesh/sugjerimesh.

Gjithashtu, KLJGJ ka vijuar procedurën e plotësimit të vakancave në sistemin gjyqësor. Konkretisht:

Vakanca në Gjykatën e Lartë	Vakanca në Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
<ul style="list-style-type: none"><li>• KLJGJ po verifikon për kandidatin e 4-të në fushën e së drejtës civile, me qëllim plotësimin e vakancës në Gjykatën e Lartë;</li><li>• KLJGJ ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve për 6 pozicione të lira;</li><li>• KLJGJ ka nisur procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të 11 kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve për në Gjykatën e Lartë, që kanë aplikuar për 2 pozicione</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• KLJGJ ka hapur 5 pozicione të lira për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;</li><li>• KLJGJ ka hapur 5 pozicione të lira për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;</li><li>• KLJGJ ka filluar procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore për 4 kandidatët që kanë aplikuar për 2 pozicione të lira pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe asaj të Apelit</li></ul>

Ka miratuar Memorandumin e Mirëkuptimit me USAID<sup>44</sup>, me qëllim ofrimin e kontributit në uljen e çështjeve të prapambetura, parandalimin e shtimit të mëtejshëm të numrit të tyre, si dhe zbatimin e praktikave më të mira për menaxhimin e lëvizjes së çështjeve në Gjykatën e Lartë.

Nga monitorimi online i faqes zyrtare të KLJGJ-së rezulton se transparenca është në nivele të kënaqshme, për shkak se krahas publikimit të vendimmarrjeve përkatëse rezultojnë të publikuara dhe procesverbalet e regjistrimet audio të mbledhjeve të realizuara online.<sup>45</sup>

<sup>44</sup> Këshilli në mbledhjen e datës 30.03.2020 mori vendimin nr. 131 "Për miratimin e nismës për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë", i ndryshuar me vendimin nr. 147 datë 28.04.2020.

<sup>45</sup> <http://klgj.al/permbledhja-e-diskutimeve/>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ashtu si në praktikën e ndjekur nga ana e KLP-së, konstatojmë se në faqen e internetit nuk rezultojnë të publikuara projektvendimet, relacionet, etj.

### 3.1. AKTET NORMATIVE DHE REALIZIMI I SEANCAVE GJYQËSORE ONLINE

Më datë 24.03.2020, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 243, vendosi të shpallë gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19.<sup>46</sup> Nëpërmjet vendimit nr. 18/2020, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dha pëlqimin për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shpallur nëpërmjet vendimit të sipërcituar.<sup>47</sup> Sipas këtij vendimi gjendja e fatkeqësisë natyrore mbetet në fuqi **deri më datë 23 Qershor 2020**.

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Ministrave ka miratuar një sërë aktesh normative me fuqinë e ligjit të cilat kufizojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, të diktuar nga gjendja e fatkeqësisë natyrore. Me Aktin Normativ nr. 9, dt. 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, Këshilli i Ministrave përcaktoi masat e veçanta dhe efektet që ato kishin në fushën e veprimtarisë gjyqësore. Përpos shtyrjes së seancave gjyqësore të planifikuara deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar në vend, parashikohet dhe pezullimi i afateve për ngritjen e padive, paraqitjen e ankimeve si dhe kryerjen e çdo veprimi procedural të parashikuar për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor. Nëpërmjet këtij akti normativ, parashikoheshin si përjashtime:

<b>ÇËSHTJET ADMINISTRATIVE</b>	<b>ÇËSHTJET FAMILJARE</b>
Me objekt gjykimin e masave të sigurimit të padisë, në rast se gjykata vlerëson se shqyrtimi pas përfundimit të gjendjes së epidemisë, mund të shkaktojë një dëm të rëndë e të pariparueshëm për palët.	Me objekt gjykimi kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturve, kujdestarinë dhe birësimin, masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përkujdesjen dhe detyrimet për ushqim, si dhe në ato çështje civile në të cilat, përjashtimisht, gjykata vlerëson se shqyrtimi i vonuar i tyre mund të shkaktojë dëm të rëndë e të pariparueshëm për palët.

### ÇËSHTJET PENALE

Që lidhen me vleftësimin e arrestit në flagrancë ose ndalimit, caktimin, verifikimin e kushteve e të kritereve të caktimit dhe nevojat e sigurimit, zëvendësimin, revokimin,

<sup>46</sup> <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-243-date-24.3.2020.docx..pdf>

<sup>47</sup> <https://www.parlament.al/Files/Akte/20200424110856vendim%20nr.%2018,%20dt.%2023.4.2020.pdf>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

**bashkimin ose shuarjen e masave të sigurimit të “arrestit në burg” ose të “arrestit në shtëpi”, kur të arrestuarit, të pandehurit ose mbrojtësit e tyre kërkojnë që të vijohet me shqyrtimin e tyre, si dhe në çështjet penale që lidhen me caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive”;**

**Afatet e kohëzgjatjes maksimale të paraburgimit, sipas pikës 6, të nenit 263, të Kodit të Procedurës Penale, mbarojnë gjatë periudhës së pezullimit;**

**Në çështjet penale të një natyre urgjente, për shkak të nevojës së sigurimit të provës, sipas nenit 316, të Kodit të Procedurës Penale;**

**Në çështjet penale në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, kur ndaj tyre është zbatuar masa e arrestit apo e ndalimit, sipas nenit 15, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;**

**Në çdo çështje tjetër penale, ku i pandehuri është i paraburgosur ose është duke vuajtur dënimin me burgim, në rast se i pandehuri ose mbrojtësi i tij kërkojnë vazhdimin e gjykimit.**

Në nenin 4 të këtij Akti Normativ është vendosur realizimi i seancave gjyqësore dhe rrjedhimisht pjesëmarrja në distancë vetëm e personave të dënuar apo me masë sigurimi “arrest në burg”, si dhe përfaqësuesve ligjorë të tyre. Atje ku është e mundur, ky akt normativ ka parashikuar realizimin e tyre nëpërmjet ndërlikohjes audiovizive.<sup>48</sup>

Problematikat dhe vështirësitë e shkaktuara në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi të qytetarëve dhe kryesisht shtetasve të ndodhur në kushtet e privimit të lirisë, por gjithashtu bazuar edhe në vendimin e KLGJ-së për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në dt.27 Prill 2020, sollën ndryshime në këtë akt normativ. **Nëpërmjet Aktit Normativ nr. 21, dt. 27.05.2020 u reflektuan disa ndryshime në aktin e sipërcituar. Këto ndryshime konsistojnë në:**

- a) Rifillimin e zhvillimit të seancave gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, duke zbatuar masat organizative specifike për zhvillimin e proceseve gjyqësore, të nevojshme për të shmangur grumbullimet në ambientet e gjykatave dhe brenda sallave gjyqësore;
- b) Shfuqizimin e parashikimeve përjashtuese dhe parashikimeve me karakter pezullues të afatit të ngritjes së padisë, depozitimit të ankimeve apo kryerjes së veprimeve të ndryshme procedurale;
- c) U kufizua hyrja e publikut në ambientet e gjykatave;

<sup>48</sup> Ligj nr. 30/2020 “Pwr miratimin e aktit normativ, me fuqinw e ligjit nr. 9, dt. 25.03.2020”, publikuar nw FZ nr. 86, dt. 13.05.2020. Link: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/04/16/30/4a8fc580-ca86-43b0-8429-88adc1ca2ceb>





## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- d) Të gjitha seancat gjyqësore publike do të zhvillohen me dyer të mbyllura;
- e) Zgjerohet kategoria e subjekteve të cilat kanë të drejtë të marrin pjesë në distancë në seanca gjyqësore. Konkretisht parashikohet pjesëmarrja e palëve, ndërhyrësit kryesor, ndërhyrësit dytësor, personit të tretë ose përfaqësuesve të tyre, prokurorit, të pandehurit, të paraburgosurit, avokatit mbrojtës, viktimës, viktimës akuzuese, paditësit, të paditurit civil, avokatit të shtetit, dëshmitarëve, ekspertëve, përkthyesve si dhe çdo pjesëmarrësi tjetër të përfshirë ose të interesuar. Kjo pjesëmarrje do të sigurohet nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive në distancë, vetëm pasi palët të kenë dhënë pëlqimin brenda afatit të parashikuar nga gjykata.
- f) Provat, dokumentet shkresore si dhe çdo akt tjetër procedural i paraqiten gjykatës ose edhe palëve nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik si dhe dërgohen, brenda të njëjtës ditë, nëpërmjet shërbimit postar, me dërgesë të porositur.

**Pavarësisht dobishmërisë së Aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, dt. 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19” dhe ndryshimeve të mëpasshme të tij (në dt.27 Maj 2020), KShH vëren se miratimi i aktit nuk u harmonizua reciprokisht në kohë me veprimtarinë e KLGJ-së për pezullimin dhe rifillimin e punës në gjykata si dhe me dispozitat e legjislacionit procedural (civil, penal dhe administrative). Konkretisht:**

**Së pari**, teksta Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi të rifillojë veprimtarinë dhe shërbimet gjyqësore në gjykata në dt. 27 Prill 2020, akti normativ me fuqinë e ligjit (i miratuar në Kuvend) i hapi rrugë rifillimit të punës në gjykata në dt. 27 Maj 2020, pra gati një muaj me vonë, pasi ai pësoi ndryshimet e përmendura më sipër. Praktikisht veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore rezultojnë se kanë filluar pas dt.27 Maj, duke pezulluar punën në gjykata për gati tre muaj.

**Së dyti**, neni 4 pika 3 i Aktit Normativ nr. 9/2020, përcaktoi Këshillin e Lartë Gjyqësor për sigurimin e mjeteve dhe programeve kompjuterike të nevojshme për mundësimin e ndërlidhjes në distancë. Pavarësisht se ky akt normativ ka hyrë në fuqi më datë 25 Mars 2020, KLGJ rezulton të ketë miratuar përdorimin e programit kompjuterik “Microsoft Teams”, që mundëson ndërlidhjen audiovizive në distancë për zhvillimin e seancave gjyqësore, më dt. 27 Prill 2020.<sup>49</sup> Pra me 34 ditë vonesë, ose 1 muaj e 4 ditë. Sikurse është përmendur më herët, mugon informacioni zyrtar nëse gjatë kësaj periudhe, pra deri në miratimin e përdorimit të programit kompjuterik janë realizuar seanca gjyqësore.

**Së treti**, nga informacioni i përcjellë nga KLGJ më datë 26 Maj 2020,<sup>50</sup> rezulton se Komisioni i Përkohshëm i ngritur, pas konsultimit me partnerët ndërkombëtarë, po vijon punën për përgatitjen e rregullores lidhur me pjesëmarrjen në distancë në seanca gjyqësore,

<sup>49</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/VENDIM-Nr.-145-dat%C3%AB-27.04.2020-P%C3%8BR-MIRATIMIN-E-P%C3%8BRDORIMIT-T%C3%8B-PROGRAMIT-KOMPJUTERIK-%E2%80%9CMICROSOFT-TEAMS%E2%80%9D-Q%C3%8B-MUND%C3%8BSON-ND%C3%8BRLIDHJE-1-1.pdf>

<sup>50</sup> Shkresa nr. 2176/1 prot “Kthim përgjigje”.



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

e cila është e domosdoshme për funksionimin e tyre. Pra kadri i plotë që normon zhvillimin e seancave gjyqësore në distancë ende nuk është miratuar plotësisht, edhe pse kanë kaluar disa javë nga ndryshimet e bëra në aktin normativ me fuqinë e ligjit.

**Së katërti**, në ndryshimet e bëra në aktin normativ, parashikohet që seancat gjyqësore do të zhvillohen me dery të mbyllura, ndërkohë që diskrecioni për këtë, sipas Kodit të Procedurës Civile dhe atij Penal është atribut eskuziv që rast pas rasti i përket trupit gjykues, bazuar në rrethanat e parashikuara në dispozitat përkatëse të këtyre dy Kodeve. Akti normativ me fuqinë e ligjit nuk mund të rregullojë çështje të cilat janë objekt i rregullimit të ligjeve që kërkojnë shumicë të cilësuar, referuar këtu edhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese (Nr. 5, datë 5.2.2014).

**Së pesti**, vendimet e KLGJ-së dhe akti normativ me fuqinë e ligjit (i ndryshuar) nuk rezultojnë të jenë në pajtim të plotë me Kodin e Procedurës Civile dhe atë Penale. Përdorimi i sistemit audio-vizual për realizimin e proceseve gjyqësore respektive është i limituar për tu përdorur nga gjykata sipas këtyre Kodeve, vetëm në raste dhe rrethana specifike që nuk përgjithësojnë përdorimin e tyre në çdo rast, në kushtet e pandemisë. Konkretisht, sipas Kodit të Procedurës Civile, zhvillimi i seancave gjyqësore me video konferencë lejohet në rastin e:

- a- Marrjes së dëshmimeve të dëshmitarëve, në shqyrtimin e padive të vogla me vlerë deri në 150 000 lekë (neni 236/a)
- b- Administrimin e shpjegimeve të palëve në lidhje me paditë e vogla me vlerë deri në 150 000 lekë (neni 285/a)

Sipas Kodit të Procedurës Penale, zhvillimi i seancave gjyqësore me mjete audio-vizive lejohet në rastin e:

- a- Regjistrimin audio-viziv të bisedës me viktimën e së mitur, kur vlerësohet e mundur dhe e përshtatshme (neni 58/a)
- b- Pyetja në distancë e të pandehurit në një procedim të lidhur, i proceduar ose që vuan dënimin jashtë shtetit për një veprë penale, kur refuzohet ekstradimi i tij, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare (neni 167/a)
- c- Me kërkesë të dëshmitarit që ndodhet brenda ose jashtë vendimit, pyetja e tij mund të bëhet në distancë, me anë të lidhjes audiovizive, duke respektuar rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (neni 361/7)
- d- Viktimat e veprave penale seksuale, veprave të trafikimit ose veprave të kryera brenda familjes, kur e kërkojnë, mund të pyeten si dëshmitarë nëpërmjet mjeteve audio dhe audiovizive (361/8).



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- e- Kur i pandehuri me sjelljen e tij pengon zhvillimin e rregullt të seancës, dhe gjykata ka urdhëruar largimin e tij nga salla për një kohë të caktuar/ ai/ajo, kur është e mundur, e ndjek seancën nëpërmjet lidhjes audio dhe/ose video (neni 344)

Sa më sipër, në veprimtarinë që lidhet me funksionin ligjvënës nga ana e Kuvendit, është e nevojshme që ky institucion të udhëhiqet nga parimet kryesore të shtetit të së drejtës, një nga të cilat është edhe domosdoshmëria e nxjerrjes së akteve juridike sipas procedurave kushtetuese e ligjore. Në përputhje me parimin e respektimit të hierarkisë së akteve normative, vlerësojmë domosdoshmërinë e respektimit të piramidës së përcaktuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që nënkupton epërsinë e Kodit i cili është miratuar me shumicë të cilësuar dhe aktit normativ me fuqinë e ligjit, i cili është miratuar me shumicë të thjeshtë parlamentare.<sup>51</sup>

**Këto çështje të diskutueshme nga pikëpamja ligjore përforcohen edhe në qëndrimin e KLGJ-së, e cila në korrespondencën zyrtare reflekton qëndrimin se (citojmë) “në kushtet kur kjo situatë mund të vijojë për një kohë të gjatë, por edhe kur palët në proces ndodhen në pamundësi objektive për të marrë pjesë fizikisht në procesin gjyqësor në ambientet e gjykatës, rregullimi për zhvillimin dhe pjesëmarrjen në distancë në seancat gjyqësore duhet të parashikohet në kodet e procedurave”.**<sup>52</sup>

Garancitë formalo-ligjore lidhur me përdorimin e mjeteve audio-vizuale për palët ndërgjyqëse dhe perdoruesit e gjykatës kemi mendimin se janë tepër të nevojshme për tu sanksionuar në Kodet tona të procedurës. Kodet janë ato që parashikojnë standartet minimale procedurale që duhet të respektohen nga trupat gjykuese në një proces gjyqësor, qoftë ky me natyrë penale, civile apo administrative. Ekspertët e Këshillit të Evropës vlerësojnë se video konferenca është një mjet që mund ti shërbejë qëllimit për të cilin përdoret, sa kohë mundëson garantimin e rregullshmërisë së procesit. Por pavarësisht nga kjo, është përgjegjësi e trupit gjykues, si një mjeshtër i procesit, të ushtrojë diskrecionin që garanton se përdorimi i kësaj teknologjie mundëson zhvillimin e procesit gjyqësor në përputhje me objektivim nadhor të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (e drejta për proces të rregullt gjyqësor)<sup>53</sup>.

**Sikurse është evidentuar edhe më herët, nuk rezulton të jenë publikuar raporte apo studime zyrtare nga KLGJ, lidhur me mënyrën e funksionimit të platformës audio-vizuale të përdorur nga gjykatat, gjatë periudhës së epidemisë. Gjithashtu, mbetet e paqartë cila është procedura që është ndjekur për garantimin e të drejtës së komunikimit ndërmjet mbrojtësit ligjor dhe të paraburgosurit/dënuarit, për ato procese gjyqësore që kanë vijuar të gjykohen në tre mujorin e parë të pamendisë. Nga 6 Prill 2020, disa seanca gjyqësore online rezultojnë të jenë zhvilluar nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.<sup>54</sup> Mbetet e paqartë nëse kjo**

<sup>51</sup> Shih vendimin nr. 29, datë 21.10.2009, të Gjykatës Kushtetuese

<sup>52</sup> Shkresë nr. 2176/1 prot., dt. 26.05.2020 lëshuar nga KLGJ

<sup>53</sup> [https://www.coe.int/en/web/national-implementation/newsroom-hfii-initiative-for-legal-certainty-in-the-western-balkans/-/asset\\_publisher/1zAUIfhO3BQP/content/the-second-regional-online-round-table-on-the-impact-of-the-covid-19-pandemic-on-human-rights-and-the-rule-of-law?\\_101\\_INSTANCE\\_1zAUIfhO3BQP\\_viewMode=view/](https://www.coe.int/en/web/national-implementation/newsroom-hfii-initiative-for-legal-certainty-in-the-western-balkans/-/asset_publisher/1zAUIfhO3BQP/content/the-second-regional-online-round-table-on-the-impact-of-the-covid-19-pandemic-on-human-rights-and-the-rule-of-law?_101_INSTANCE_1zAUIfhO3BQP_viewMode=view/)

<sup>54</sup> <https://www.fairtrials.org/news/commentary-overview-how-albania-responding-covid-19-crisis>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Gjykatë ka qenë e pajisur me kushtet e nevojshme logjistike dhe teknologjike për mundësinë e realizimit të video-konferencës private ndërmjet mbrojtësit ligjor dhe të përfaqësuarit prej tij.<sup>55</sup> Pamundësia e aksesimit në të dhëna të publikuara nga ana e pushtetit gjyqësor, e ka bërë të pamundur informimin e publikut lidhur me kushtet teknologjike, vështirësitë dhe sfidat që janë hasur në raport me suportin teknik që platforma të tilla e kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme etj.

#### 4 Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) në cilësinë e një institucioni të ri kushtetues ushtron kompetenca të rëndësishme në funksion të verifikimit të ankesave të adresuara, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Ngritja e këtij institucioni më dt 1 Shkurt 2020, me zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në krye të tij, është përballur me kushte të vështira logjistike, të cilat janë bërë publike nga vetë Z. Metani. Konkretisht ky institucion disponon vetëm 1 zyrë e cila është funksionale, ndërkohë gjatë muajit Maj 2020 ngarkesa institucionale e trajtimit dhe hetimit të ankesave të depozituara nga ana e qytetarëve është mbuluar nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 1 inspektor që ushtron funksionin pranë këtij institucioni.<sup>56</sup>

Nga informacioni i përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 661/1 prot., dt. 23/05/2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ndërmarrë një sërë aktivitete gjatë periudhës së Covid-19. Konkretisht:

- Po vijon procedurat e rekrutimit të stafit, me qëllim plotësimin e pozicioneve vakant për inspektor;
- Ka kërkuar nga ana e KLGJ-së dhe KLP-së evidentimin e inspektorëve, të cilët do të konsiderohen si të komanduar pranë zyrës së ILD-së, për shkak se kanë statusin e magjistratit dhe janë caktuar për kryerjen e hetimeve disiplinore;
- Po verifikon ankesat të mbërritura nga individët dhe institucionet, si dhe po heton shkeljet disiplinore në ngarkim të magjistratëve;
- Ka iniciuar kryerjen e një inspektimi tematik pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit dhe zyrave të prokurorive, mbi trajtimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” për periudhën kohore 01.01.2017 – 31.01.2020;
- Në bashkëpunim me misionin Euralius, po punon lidhur me dixhitalizimin dhe përpunimin e ankesave, me qëllim trajtimin sa më të shpejtë të tyre.

<sup>55</sup> Ky rekomandim gjendet në: <https://www.fairtrials.org/sites/default/files/Safeguarding%20the%20right%20to%20a%20fair%20trial%20during%20the%20coronavirus%20pandemic%20remote%20criminal%20justice%20proceedings.pdf>

<sup>56</sup> <https://a2news.com/2020/05/04/puna-e-ild-se-vetem-nje-zyre-dhe-nje-inspektor-per-te-mbikqyrur-drejtisine/>





## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Duke nisur nga data 10 Mars 2020, me qëllim marrjen e masave parandaluese për mospërhapjen e epidemisë Covid-19, ky institucion ka vendosur ndërprerjen e shërbimit për pritjen e qytetarëve në ambientet e ILD-së.<sup>57</sup> Qytetarëve ju është sugjeruar adresimi i ankesave në rrugë postare apo elektronike.

#### 4. Rekomandime

**KShH do të vijojë të monitorojë në mënyrë sistematike funksionimin e institucioneve të drejtësisë, me fokus të veçantë ato të sistemit të drejtësisë penale. Me të dhënat paraprake që KShH ka garantuar në këtë fazë të parë monitorimi, vlen të adresohen këto rekomandime:**

- a- **I rekomandojmë Këshillit të Lartë Gjyqësor të monitorojë në terma sasiore dhe cilësore funksionimin e gjykatave gjatë tre muajve të parë të pandemisë, duke garantuar akses të gjerë të publikut në këto të dhëna.**
- b- **I rekomandojmë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe atij Gjyqësor, të identifikojnë problematikat që janë hasur nga prokuroria dhe gjykata dhe në bashkërendim të hartojnë një plan strategjik masash që mundëson kapërcimin e këtyre problematikave në rast të vijueshmërisë së pandemisë globale edhe pas verës së këtij viti (referuar të dhënave të epidemiologëve rezulton që në vjeshtën e këtij viti pandemia do të përsëritet dhe pritet të prekë një numër më të gjerë të popullatës);**
- c- **I rekomandojmë KLGJ-së dhe KLP-së të shoqërojnë me relacione arsyetuese vendimmarrjet, veçanërisht ato me natyrë individuale që kanë të bëjnë me caktimin e përkohshëm në pozicion, etj.**
- d- **I rekomandojmë Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me Kuvendin e RSH të ndërmarrin një nismë ligjore që mundëson rishikimin e Kodit të Procedurës Civile dhe atë Penale, me qëllim që të parashikohet si formë për zhvillimin e seancave gjyqësore, realizimi i tyre me mjete të përshtatshme audio-vizuale.**
- e- **I rekomandojmë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të garantojë transparencë më të gjerë për publikun lidhur me trajtimin e ankesave që janë në proces verifikimi ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve (të mbartura dhe ankesat pas ngritjes së ILD) si dhe informacion periodik për vendimmarrjen e ILD lidhur me këto ankesa.**

<sup>57</sup> <https://ild.al/2020/03/10/njoftim/>



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

## ANNEX 1

**Shkresa datë 11 Maj 2020 “Kërkesë për informacion mbi hapat e ndërmarrë për vijueshmërinë e punës për zbatimin e reformës në drejtësi dhe rifillimin në mënyrë të plotë të veprimtarisë gjyqësore në vendin tonë, në kushtet e pandemisë globale Covid-19”, drejtuar KLP, KLGJ, KED, KPA, Komisionerit Publik, KPK, Prokurorit të Përgjithshëm dhe ILD.**



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 11 Maj 2020

**Drejtuar:** Z. Gent Ibrahim  
Kryetar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Znj. Naureda Llagami  
Kryetare, Këshilli i Lartë Gjyqësor

Z. Ardian Dvorani  
Kryetar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Znj. Natasha Mulaj  
Kryetare, Kolegji i Posaçëm i Apelimit

Z. Florian Ballhysa, Komisioner Publik  
Z. Darjel Sina, Komisioner Publik

Znj. Genta Bungo  
Kryetare, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Z. Olsian Çela  
Prokuror i Përgjithshëm

Z. Artur Metani  
Inspektor i Lartë i Drejtësisë

**Lënda:** Kërkesë për informacion mbi hapat e ndërmarrë për vijueshmërinë e punës për zbatimin e reformës në drejtësi dhe rifillimin në mënyrë të plotë të veprimtarisë gjyqësore në vendin tonë, në kushtet e pandemisë globale Covid -19

### **Të nderuar përfaqësues të lartë institucioneve të sistemit të drejtësisë,**

Urojmë të jeni mirë me shëndet e punët t'ju shkojnë mbarë.

Në datën 24 Mars 2020, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.243, shpalli me afat një muaj, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Shqipërinë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Në datën 23 Prill 2020, në mbështetje të neneve 100 dhe 174, pika 2, të Kushtetutës, Kuvendi i Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, dha pëlqimin për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore deri në datën 23 Qershor 2020 (me vendimin nr. 18/2020).

Gjendja e fatkeqësisë natyrore është shoqëruar me miratimin e një kuadri të ri ligjor, që parashikon masa të jashtëzakonshme për vijueshmërinë e punës së institucioneve, kufizimin e lirisë së lëvizjes së qytetarëve, të veprimtarisë së bizneseve, për mbështetjen me ndihmë



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE



financiare ndaj subjekteve të caktuara (individë/biznese), etj. Një nga këto masa është akti normativ me fuqinë e ligjit, nr.9, datë 25.03.2020, i Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19” (miratuar me ligjin nr.30/2020, dt.16.04.2020 nga Kuvendi i RSH). Sipas neni 3, pika 1 e këtij ligji, seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, të planifikuara pranë të gjitha gjykatave, shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19. Në pikën 3 të këtij ligji, parashikohet vazhdimësia e vetëm një numri të kufizuar çështjesh me natyrë administrative, familjare dhe penale. Në kushtet e kësaj fatkeqësie natyrore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar udhëzimin Nr. 146, datë 27.04.2020 “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”.

Organizatave të shoqërisë civile, kanë reflektuar edhe më herët qëndrimin e tyre, duke vlerësuar në tërësi masat e marra nga autoritetet shtetërore, për parandalimin dhe luftën ndaj pandemisë globale Covid 19. Sipas deklaratave zyrtare, këto masa kanë kontribuar në drejtim të uljes së shtetasve të infektuar me Covid 19 në vendin tonë dhe për pasojë edhe në numrin e viktimave që kanë humbur fatkeqësisht jetën nga beteja me këtë virus.

Në këtë situatë, organizatat e shoqërisë civile sjellin në vëmendje nevojën që institucionet tona të drejtësisë të avancojnë me zbatimin e reformës në drejtësi, duke marrë masa dhe aplikuar forma të përshtatshme të veprimtarisë së tyre që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve dhe punonjësve të institucioneve nga Covid 19. Gjithashtu këto masa, duhet të garantojnë çdo aspekt të të drejtës për proces të rregullt, në përputhje me nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Reforma në drejtësi dhe ecuria e saj ka qenë një nga zhvillimet më të rëndësishme për hapjen e negociatave të Shqipërisë në 26 Mars 2020 nga Këshilli i Bashkimit Evropian. Rekomandimi pozitiv i BE-së në kuadër të hapjes së negociatave, kërkon gjithashtu vijueshmërinë e hapave konkrete nga autoritetet, për të shënuar progres të mëtijshëm për integrimin e vendit në familjen evropiane, i cili do të vlerësohet sipas një metodologjie të re. Në raport me këtë proces, veprimtaria dhe arritja e objektivave nga institucionet e reja të drejtësisë, merr një rëndësi parësore, duke patur veçanërisht në fokus:

- a) marrjen e masave për rifillimin e gjyqësorisë së çështjeve që janë pezull në sistemin gjyqësor, pasi aksesimi në drejtësi dhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm janë aspekte të rëndësishme të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor.
- b) vijueshmërinë me prioritet të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si procesi më i rëndësishëm tranzitor që po kontribuon pozitivisht për pastrimin e sistemit të drejtësisë. Në një kohë kur kanë ngelur vetëm dy vite nga përfundimi i mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk kanë përfunduar procesin e rivlerësimit as gjysma e trupës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- c) Plotësimin e vakancave në Gjykatën Kushtetuese, e cila vijon të jetë jofunksionale për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje. Në kushtet e marrjes së masave të jashtëzakonshme, kur disa nga të drejtat dhe liritë e njeriut janë kufizuar, mosfunksionimi i kësaj gjykate cenon potencialisht aksesin e subjekteve që legjitimohen për të kërkuar



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE



FONDACIONI SHOQËRIA  
E HAPUR PËR SHQIPËRINË



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE  
INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES  
www.isp.com.al



Qendra  
për Studimin  
e Demokracisë  
dhe Qeverisjes

kontrollin kushtetues abstrakt të normës, interpretimin përfundimtar të normës kushtetuese, gjykimin e kërkesave individuale, etj.

- d) Plotësimin e mëtejshëm të vakancave në Gjykatën e Lartë, për të garantuar funksionimin e plotë dhe me efikasitet të këtij institucioni me një stok prej 35.000 çështjesh gjyqësore të mbetura pezull. Gjithashtu, nevojitet plotësimi i vakancave në gjykatat e niveleve të tjera si dhe në nivelin e prokurorisë.
- e) Shqyrtimin me prioritet të ankesave të individëve apo subjekteve të tjera që pretendojnë shkelje disiplinore, të cilat kanë krijuar një stok të mbartur prej gati dy vitesh, si pasojë e krijimit me vonesë të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- f) Përfundimin e procedurave që lidhen me zgjedhjen e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit si edhe zgjedhjen e 60 hetuesve. Vrijimin e procedurave të tjera në funksion të plotësimin të strukturës organizative të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, me qëllim ushtrimin e plotë të kompetencave të këtyre organeve.

Sa më sipër, në përputhje me kompetencat e institucioneve që ju drejtoni dhe bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit" do të vlerësonim dhënien e një informacioni në rrugë zyrtare mbi hapat e ndërmarra apo që planifikohen të ndërmerren (duke përcaktuar edhe afatet kohore konkrete), për vijueshmërinë e veprimtarisë së sistemit të drejtësisë, në kushtet e pandemisë globale Covid – 19.

Me respekt,

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Instituti për Studime Politike

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes



Fondacioni Shoqëria e Hapur  
Për Shqipërinë

Rr. Qemal Stafa, Nr. 120/2, Tirane

